



Aleanca për
Media
Etike

VENDIM Nr.81

Ankuesi: Z. Dren Paca

Kundër: Pamfleti.net

Titulli i artikullit objekt ankimimi:

Kështu funksionon krimi, Dren Paca prokuror i prokurorisë speciale me shokët e tij në krim

Vjegëza e artikullit objekt ankimimi:

<https://pamfleti.net/prishtine/keshtu-funksionon-i-dren-paca-prokuror-i-prokurorise-speciale-me-s-i195439>

Bordi i Aleancës për Media Etike pasi shqyrtoi ankesën,

KONSTATOI

1. Titulli i artikullit është akuzë e drejtpërdrejtë për z. Paca.
2. Artikulli ka akuza të cilat nuk mbështeten në fakte.
3. Artikulli është i pa balancuar, pasi në të nuk është paraqitur versioni i palës së prekur. Edhe pse z. Paca ka tentuar të kontaktojë me median Pamfleti.net, nuk ka mundur të marrë një përgjigje nga media për të dhënë versionin e tij.
4. Media Pamfleti nuk ka verifikuar informacionet të cilat i ka marrë të gatshme nga mediat të cilat i ka cituar në artikull.



Aleanca për
Media
Etike

Nenet e shkelura sipas Kodit të Etikës së Gazetarit:

Neni 1. Saktësia dhe Ndershmëria e Informacionit. Gazetari duhet të verifikojë informacionin përpara botimit me qëllim që të sigurohet që është i saktë, i bazuar në fakte dhe i besueshëm. Gazetarët duhet të bëjnë çmos për të ofruar raportim të paanshëm dhe të balancuar.

Palët e kritikuara duhet të kenë të drejtën t'u përgjigjen akuzave, mundësisht në të njëjtin organ. Gazetarët duhet të bëjnë çdo përpjekje për t'i kontaktuar të gjitha palët dhe për të mbledhur të gjitha opinionet relevante.

Mbështetur në këto arsyetime, Bordi,

VENDOSI

T'i sugjerojë medias Pamfleti.net të fshijë artikullin si dhe të publikojë një përgënjeshtim të artikullit të mëparshëm.

Publikuar më 1 Dhjetor 2023